

VENDIM
Nr.365, datë 11.6.2004

PËR KRIJIMIN E MËNYRËN E MBAJTJES SË REGJISTRIT KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE DHE PËR RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË TEKNIKËS DHE RRJETIT INFORMATIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 pika 3 e 31 pika 2 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, bazë e të dhënave të gjendjes civile për çdo shtetas, krijohet nga grumbullimi i të dhënave të regjistrave themeltarë të gjendjes civile.

2. Krijimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile fillon me procedurën e transkriptimit të të dhënave të regjistrave themeltarë të zyrave të gjendjes civile dhe realizohet vetëm në mjediset e këtyre zyrave.

3. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile vendoset në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe ruhet si objekt i rëndësisë së veçantë.

4. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile mbahet në dy kopje, njëra prej të cilave nuk është në përdorim dhe ruhet në arkiva të posaçme, si objekt i rëndësisë së veçantë.

5. Në sistemin informatik, ku mbahen dhe përpunohen të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, përveç të dhënave ekzistuese dhe elementeve përbërëse të dokumentit të identitetit të shtetasve, të përfshihen edhe të gjitha transaksionet, që do të kryhen për një periudhë kohore prej 20-vjetësh.

6. Rrjeti informatik përbëhet nga sistemi elektronik i Regjistrit Kombëtar, regjistrat elektronikë të gjendjes civile dhe sistemi i komunikimit ndërmjet tyre.

7. Sistemi i komunikimit të jetë me përditësim/konsultim të drejtpërdrejtë (on line) ose përditësim/konsultim të vonuar (off line).

8. Sistemi i komunikimit on line të jetë për:

a) të gjitha bashkitë dhe njësitë bashkiake të Tiranës;

b) të gjitha komunat, që kanë mbi 10 000 banorë.

9. Institucionet, që kanë të drejtë të marrin të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në përputhje me fushën e veprimtarisë së tyre, janë:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

b) Ministria e Rendit Publik;

c) Ministria e Drejtësisë;

ç) Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale;

d) Shërbimi Informativ i Shtetit;

dh) Organet tatimore dhe doganore;

e) Organet e prokurorisë;

ë) Institucionet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

f) INSTAT-i.

10. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano